RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

Ftesë për aplikantë

PËR PUNË PRAKTIKE

Në bazë të marrëveshjes në mes të RTK-së dhe UNICEF, RTK publikon shpalljen për:

PRAKTIKANTË:

(me pagesë)

Gazetar në ueb page – 2 praktikantë;

Gazetar në dhomën e lajmeve në RTK-TV – 2 praktikantë;

Gazetar në RTK-Radio – 2 praktikantë;

Gazetar në RTK2-TV – 2 praktikantë

Teknik i zërit në RTK-Radio – 2 praktikantë

Kosova Generation Unlimited (K-GenU) është një koalicion shumë-sektorial për bashkëpunim, me qëllim të rritjes së investimeve për dhe me të rinjtë, që ata të mund të shfrytëzojnë dhe rrisin potencialin e tyre. K-GenU fuqizon dhe angazhohet me të rinjtë duke i lidhur ata me mundësinë për të përmirësuar apo lehtësuar kalimin e tyre nga shkolla në punë, përmes programit të punës praktike. Ky program shoqërohet me trajnime për zhvillimin e aftësive dhe monitorim për të lehtësuar përvojën e të rinjve në tregun e punës.

Me angazhimin në programin e punës praktike (K-GenU), të rinjtë përfitojnë mundësi:

- Të ndërtojnë CV-në e tyre
- Të lidhen me entitete të sektorit publik dhe privat
- Të angazhohen në punë praktike tre mujore- me kompensim financiar, duke u bazuar në fushën e tyre të interesit
- Të ju caktohen mentorë për ngritjen e kapaciteteve dhe mbështetjen përgjatë rrugëtimit të tyre
- Të përfitojnë nga mundësitë e trajnimit dhe qasjen në qendrën e Burimeve të (K-GenU)

Praktika mund të bëhet në RTK-TV (RTK1-TV, RTK2-TV, RTK3-TV) dhe në RTK-Radio për periudhën deri në 3 muaj.

Kushtet e përgjithshme për aplikantët:

- Të jenë të moshës 16-24 vjeç
- Të jenë shtetas të Kosovës me vendbanim në Kosovë
- Të mos jenë në marrëdhënie pune
- Të mos kenë qenë të punësuar në RTK deri në momentin e angazhimit në K-GenU

Të interesuarit duhet të aplikojnë përmes platformës K-Gen-U në ueb faqen si më poshtë:

https://kosovogenu.com/

Nga ana e RTK-së varësisht nga lloji i praktikës do të caktohet mentori i cili do të përcjellë punën praktike në RTK.

Praktikantët të cilët do të hyjnë në listën e ngushtë do të ftohen për intervistë.

RTK ka të drejtë të kërkojë edhe sqarime dhe dokumentacion shtesë në mënyrë që vlerësimi të jetë sa më i saktë.

Afati për aplikim është duke filluar nga 21.02.2024 deri më 15.03.2024.